



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 28 Dt. 10.04.2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “LAJTHIZA INVEST” SH.A**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”,me propozim të A.B.U Drin- Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore , pas shqyrtimit të dokumentacionit perkatës , Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**Vendosi:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “LAJTHIZA INVEST” SH.A me administrator **Z.Thanas SIVERI** , për përdorim të rezervës ujore **Përroi i Sërriqes ,Satrave dhe te Vales** degë të lumit Drin , për prodhim energjie elektrike në fshatin Qam ,Njësia Administrative Malzi , **Bashkia Kukës , Qarku Kukës** . Sipas studimit të paraqitur nga subjekti objekti **HEC QAMI 1** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes Nr1: X1 – 44 30 801 ; Y1 – 46 55 305 ; Z1 – + 568 m  
Koordinatat e veprës së marrjes Nr.2: X2 – 44 32 049 ; Y2 – 46 56 947 ; Z2 – + 568 m  
Koordinatat e veprës së marrjes Nr.3: X3 – 44 32 899 ; Y3 – 46 59 203 ; Z3 – + 563 m  
Koordinatat e godinës së centralit: X – 44 33 748 ; Y – 46 60 722 ; Z – +412 m  
Koordinatat e pikes së shkarkimit : X – 44 33 748 ; Y – 46 60 722 ; Z – +412 m  
Prurja mesatare e përroit: Q1mes= 0.874 m<sup>3</sup>/sek; Q2mes= 0.353 m<sup>3</sup>/sek; Q3mes= 0.136 m<sup>3</sup>/sek  
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 1.5 m<sup>3</sup>/sek;  
Prurja ekologjike: Q ekol= 0.13 m<sup>3</sup>/sek;  
Prurja që shkarkohet: Q= 1.5 m<sup>3</sup>/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të rezervës ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETARI**  
**Martin PLLUMBI**



**KRYETARI**  
**Paulin RADOVANI**